



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

CSR 2019

Bankat për shoqërinë





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



VJET RAPORT CSR

BANKAT PËR SHOQERINË



PARATHËNIE

I nderuar lexues,

Kushdo që mund të jesh dhe ke shprehur interes të shfletosh këtë publikim të veçantë nga Shoqata Shqiptare e Bankave, e vetmja që publikon një përmbledhje të kësaj natyre, je i mirëpritur t'i bashkohesh përpjekjeve tona për një shoqëri dhe ekonomi më të mirë, për një ambient të pastër dhe të shëndetshëm që ndihmon një zhvillim të qëndrueshëm.

Na bie barra ne, më shumë se brezat paraardhëse, të kujdesemi për brezat e nesërm. Jeta duhet të vazhdojë me cilësi të përmirësuar. Ta ruajmë gjithçka kemi si bazën e jetës për nesër. Të bëjmë të gjithë sa mundemi, duke sakrifikuar diçka nga vetja, në emër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Bankat e kanë zgjedhur pozicionin e tyre. Jo vetëm veprimtari tregtare, por edhe kontribut në shoqëri.

Gjatë vitit 2019 mbi 15 miliardë lekë kredi kanë shkuar në mbështetje të 11 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, mbi 370 milionë lekë janë shpenzuar në mbështetje të komunitetit, grupeve të caktuara, sektorëve të veçantë, si kontribute të përgjegjësishë shoqërore korporative.

Ne jemi krenarë që po ecim në këtë rrugë dhe që me transparencë dhe profesionalizëm po ja paraqesim publikut çdo vit. Gjatë leximit ju do të ndeshni aktivitetin e gjerë të zhvilluar brenda një viti nga 12 bankat. Me siguri diku do të gjeni edhe veten tuaj. Sepse qëllimi është që e gjithë kjo të jetë e prekshme, të jetë për njerëzit dhe te njerëzit.



Falënderim i veçantë kolegëve të industrisë bankare për përfshirjen e tyre në këto programe ndërkombëtare dhe që bashkojnë përpjekjet në kuadër të një interesi më të gjerë se të bankës së vet. Mundi, përkushtimi, profesionalizmi dhe ndershmëria i karakterizon ata në këto zhvillime cilësore. Së bashku ne ja dalim!

Bashkohu dhe ti me ne! Që nesër të kemi më shumë të tregojmë, të vetëdijshëm se stafeta e jetës duhet përcjellë e pa rrezikuar.

Lexim të këndshëm!

Me respekt,

Silvio Pedrazzi

Kryetar
Shoqata Shqiptare e Bankave

Përmbajtja

OBJEKTIVI 1	Pa Varfëri	6
OBJEKTIVI 2	Zero Uri	8
OBJEKTIVI 3	Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie	10
OBJEKTIVI 4	Arsim Cilësor	14
OBJEKTIVI 5	Barazi Gjinore	19
OBJEKTIVI 7	Energji e Përbalueshme	21
OBJEKTIVI 8	Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike	23
OBJEKTIVI 9	Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë	26
OBJEKTIVI 10	Zvogëlim i Pabarazive	30
OBJEKTIVI 11	Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	32
OBJEKTIVI 12	Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm	37
OBJEKTIVI 13	Veprim për Klimën	39
OBJEKTIVI 14	Jeta nën ujë	41
OBJEKTIVI 17	Partneritet për Objektivat	42
ART, SPORT & KULTURË	45



OBJEKTIVI #1 Pa Varfëri

Mbi **10** milionë euro të shfrytëzuara nga garancitë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) të cilat përdorin teknologji të reja dhe prodhojnë produkte të reja.

Rreth **3.200.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Ofron inovacione për zhvillimin e produkteve të reja bankare, metodologjitë për vlerësimin e kredive, modellet e operimit dhe kanalet e shpërndarjes (duke përfshirë mobile banking) për përmirësimin e përfshirjes financiare, duke përfshirë edhe bankingun për 2,5 miliardë njerëz të rritur që aktualisht nuk disponojnë llogari bankare, si dhe sigurimin në nivel mikro për rritjen e mbrojtjes sociale.

Siguron për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfrit dhe personat e cenusshëm që të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe qasje në shërbimet bazë, të gëzojnë pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe formave të tjera të pronës, trashëgiminë, burimet natyrore, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë edhe mikro-financën.




DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Fondi Evropian i Investimeve (EIF), pjesë e Grupit Evropian të Bankës së Investimeve, dhe **Grupi ProCredit** kanë ofruar 800 milionë euro shtesë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), të cilat përdorin teknologji të reja dhe prodhojnë produkte të reja, duke sjellë një total prej 1,62 miliardë euro për shoqëritë në njëmbëdhjetë vende, përfshirë Shqipërinë. Marrëveshjet me ProCredit kanë mbështetur rreth 2000 NVM novatore, kryesisht në sektorët e prodhimit dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë, dhe shumë më tepër do të financohen në vitet e ardhshme.

Këto marrëveshje u nënshkruan nën iniciativën e Komisionit Evropian "InnovFin", mbështetur nga programi i BE-së për





hulumtim dhe inovacion “Horizon 2020”. Iniciativa “InnovFin” u mundëson bankave pjesëmarrëse të ofrojnë kredi për ndërmarrjet novatore me mbështetjen e një garancie të dhënë nga EIF. Marrëveshjet e nënshkruara në vendet e Shteteve Anëtare të BE-së u mundësuan nga mbështetja e Fondit Evropian për Investime Strategjike (EFSI). EFSI është shtylla kryesore e Planit të Investimeve të Komisionit Evropian për Evropën, i njohur gjithashtu si “Plani Juncker”.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania bashkëpunoi me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe nëpërmjet përfshirjes institucionale dhe kontributit vullnetar të disa punonjësve të saj, mundësoi pako ushqimore për mensën ku shërbehen familjet në vështirësi ekonomike, si dhe organizoi një festë fundviti për fëmijët e familjeve në vështirësi.

Credins Bank

- Mbuloi shpenzimet mujore të disa fëmijëve të SOS Fshatrat e Fëmijëve, duke u dhënë atyre më shumë mundësi për një të ardhme më të mirë në drejtim të shkollimit dhe mirëqenies së tyre.
- Në 28 maj, në Qendrën Sociale të degës së Kryqit të Kuq Shqiptar në Tiranë, u realizua një festë me 50 fëmijë jetimë që jetojnë në komunitet, dhe u mundësuan dhe dhurata për të gjithë fëmijët.
- Mundësoi festimin e ditës së Bajramit në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, duke iu bashkuar drekës me banorët e kësaj shtëpie.
- Përfaqësuesit e Bankës vizituan Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë, ku u dhuruan 20 dyshekë për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të qendrës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Punonjësit e bankës bashkëpunuan me “La Casa nel Cuore” dhe dhuruan çanta dhe mjete shkollore për fëmijët, të cilët nuk kanë mundësi financiare për ti blerë ato.
- Mbështeti Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me rastin e festave të fundvitit 2019, të organizuara për të mbështetur familjet e 226 oficerëve të policisë të rënë në krye të detyrës.
- Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, gjatë muajit tetor, punonjësit e bankës mblodhën në mënyrë vullnetare një sasi të konsiderueshme veshjesh për t’u ardhur në ndihmë njerëzve dhe familjeve në nevojë.

Tirana Bank bashkëpunoi me Fondacionin “Fundjavë Ndryshe” dhe mundësoi një mjedis të ri banimi për familjen Poka.



OBJEKTIVI #2 Zero Uri

Marrëveshje bashkëpunimi me qeverinë dhe institucione financiare për rritjen e financimit për një bujqësi të qëndrueshme në shumën mbi

3.000.000.000 lekë.

Financim i agro bizneseve: **593** kredi të reja të dhëna gjatë vitit 2019, në vlerën **2.406.000.000** lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: **13.747.043.000** lekë.

Rreth **320.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për aritjen e objektivit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet financiare për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme.
- Bashkëpunim me shoqëri të tjera, Qeverinë dhe shoqërinë civile për identifikimin e mundësive të reja të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të biznesit (p.sh., financimi i farës dhe risive në mikro-ushqyerje).
- Sigurimi i qasjes për të gjithë njerëzit, në veçanti për të varfrit dhe njerëzit në situata të cënueshme, duke përfshirë edhe foshnjat, në ushqime të sigurta, ushqyese dhe të mjaftueshme gjatë gjithë vitit.



DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

Përmirësimi i qasjes ndaj shërbimeve financiare për agrobiznesin, një seminar i organizuar më 24 shtator nga **Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)** në bashkëpunim me European Fund for Southeast Europe, Development Facility (EFSE DF) dhe RisiAlbania, mbështetur nga Agjencia Zvicërane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Në këtë veprimtari u prezantua **Një udhëzues praktik për Agrobiznesin**, i cili u vjen në ndihmë sipërmarrësve të bi-





zneseve rurale me njohuri financiare.

Me mbështetjen e Fondit Evropian të Investimeve, BERZH-it dhe institucioneve financiare, bankat ofrojnë produkte që u japin mundësi kreditimi edhe bizneseve të cilat nuk plotësojnë kushtet e mjaftueshmërisë së kolateralit, sipas procedurave kredituese të bankës, si p.sh. kredia Agro dhe COSME, si dhe ofrojnë këshillim për fermerët.

Alpha Bank Albania, Credins Bank dhe Fondi Evropian i Investimeve (EIF) finalizuan me sukses një projekt të rëndësishëm, i cili do të shërbejë për të mbështetur ndërmarrjet shqiptare të vogla, të mesme dhe agro në kuadër të programit për garantimin e huave – COSME, të ofruar nga Bashkimi Evropian. Ky financim është bërë i mundur nëpërmjet mbështetjes së garancisë së BE-së për financimin e borxhit, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Huave, të krijuar në përputhje me Rregulloren (EU) Nr. 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e një Programi për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (COSME) (2014-2020).

Raiffeisen ka nënshkruar marrëveshje me BERZH-in për mbështetjen e sektorit Agri, si dhe ka ofruar hua afatshkurtra dhe investime për financimin e sektorit Agri.

Intesa Sanpaolo Bank Albania ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qeverinë dhe institucione financiare për rritjen e financimit për një bujqësi të qëndrueshme.

Në kuadër të Skemave Kombëtare të mbështetura nga Qeveria Shqiptare dhe programi IPARD **Procredit Bank** ofron fleksibilitet në garancinë e kërkuar në raste financimi të projekteve të ndryshme. Kjo sigurohet duke i përfshirë në fondet e garancisë që banka ka me institucionet ndërkombëtare si BERZH dhe Fondi Evropian i Investimeve (EIF).



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Banka Amerikane e Investimeve dhe **Intesa Sanpaolo Bank Albania**, në bashkëpunim me Food Bank Albania, ndërmorën nismën vullnetare të “Dhurimit të produkteve ushqimore”, në mbështetje të familjeve shqiptare në nevojë.

Credins Bank i kushton një vëmendje të veçantë kontributit në mbështetje të eliminimit të urisë në çdo lloj forme. Gjatë vitit 2019, Banka ka bashkëpunuar me organizata dhe projekte të ndryshme që ndihmojnë në arritjen e këtij objekti.

Në Ditën Botërore të Urisë, banka dhe i gjithë stafi i saj dhuroi një sasi të konsiderueshme ushqimesh në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar për familjet më të varfra të zonave përreth Tiranës, duke u ardhur në ndihmë shumë familjeve që gjenden në një varfëri ekstreme.

Gjatë datave 15-16 mars 2019, në EkspoCity u zhvillua edicioni i dytë i Agro-Tech Expo & Forum. Banka **Procredit**, me anë të pranisë së saj në AgroTech 2019, ritheksoi angazhimin e saj, ndërmarrë që prej vitit 2001, për të mbështetur zhvillimin dhe financimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri.

OBJEKTIVI #3 Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie

Investim për institucione shëndetësore: **91** kredi të reja të dhëna gjatë vitit 2019, në vlerën **1.202.418.400** lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: **1.343.838.400** lekë.

Rreth **25.000.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Sigurimi dhe/ose mbledhja e fondeve për investime për institucionet shëndetësore.
- Shqyrtimi i hartimit të politikave që përfshijnë shërbime të transfertave të parasë nëpërmjet telefonit celular për transferimin eficient të fondeve me qëllim mbulimin e kostove shtesë që lidhen me kujdesin shëndetësor shtetëror.
- Vendosja e një bashkëpunimi me ofruesit e telefonisë celulare dhe organizatat komunitare për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë shëndetin, duke reduktuar numrin e kredive të papaguara dhe kërkesat për sigurim që lindin nga çështjet shëndetësore.
- Mbështetje ndaj punonjësve, familjeve, komuniteteve dhe kombeve të shëndetshme, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurta pune.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Mbështetje për punonjësit e bankave të cilët kanë pësuar dëme materiale nga tërmeti

Credins Bank, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Procredit Albania, Raiffeisen Bank

Bankat, në mbështetje të punonjësve, banesat e të cilëve kanë pësuar dëme nga tërmeti i datës 26 nëntor, kanë akorduar ndihma financiare në varësi të shkallës së dëmeve.

Mbështetje ndaj punonjësve dhe familjeve të tyre në sigurimin e shëndetit

- Mbi 10.000.000 lekë në mbështetje të sigurimit të shëndetit





të punonjësve.

Në bazë të ligjit nr. 10237, i ndryshuar, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", bankat punësojnë një mjek, qëllimi i punës së të cilit është të udhëzojë punëdhënësin për problemet e mbrojtjes në punë për shmangien e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, dhe për çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë.

Bankat bashkëpunojnë me shoqëri të njohura të sigurimit privat dhe ofrojnë për punonjësit e tyre sigurimin shëndetësor dhe paketat vjetore të përfitimeve.


Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- Fushatën kundër kancerit të gjirit 2019 "Së bashku për fjongon rozë!", e cila u çel në muajin mars. Gjithashtu, banka ishte sponsor Platin i marshimit simbolik të fjongos rozë, që u zhvillua në datën 8 tetor në Tiranë, nën moton "Fjongo rozë më kujton!" si dhe sponsorizoi Koncertin e Bamirësisë nga Ermonela Jaho në mbështetje të "fjongos rozë", në 22 tetor.
- Në 21 prill, "Dajti trial running", vrapimin malor në malin e Dajtit.
- Në 15 shtator, edicionin e dytë të vrapimit malor "Voskopoja Trial Running", organizuar në malet e Voskopojës - shtegu i ujkut nga "Trail Running Albania".
- Në 24-26 tetor, kongresin e 5të "Kujdesi gjatë shtatzënisë dhe lindjes", mbajtur në Tiranë.
- Shoqatën shqiptare të edukimit dhe promovimit shëndetësor "Hope Albania". "Halloween 70s theme party", një festë për të luftuar stigmën dhe diskriminimin që ekziston rreth shëndetit mendor në Shqipëri. Moto e aktivitetit ishte #leteflasim, me qëllim sensibilizimin për personat që vuajnë nga ky problem, duke i nxitur ata të marrin më shumë guxim për të kërkuar ndihmë, ndërsa të tjerët të jenë më pak paragjykes ndaj tyre.
- Qendrën sociale "Të qëndrojmë së bashku" duke dhuruar një automjet, i cili do të jetë në shërbim të komunitetit të qendrës.
- Shtëpinë e Shpresës në Shën Vlash Durrës, duke dhuruar pajisje elektro-shtëpiake të cilat do të jenë në shërbim të kësaj qendre, e cila ka në vëmendje kujdesin e fëmijëve jetim.

Banka Kombëtare Tregtare, FIBank Albania dhe Tirana Bank mbështetën edicionin e 4-t të Maratonës së Tiranës, ku morën pjesë garues nga 42 vende të botës.

Credins Bank mbështeti:

- Fondacionin e Fëmijëve Shqiptarë “Dominic Scaglione” duke kontribuar për zhvillimin e fëmijëve me probleme të autizmit dhe duke sensibilizuar komunitetin për mbështetje.
- Spitalin Universitar Obstetrikë Gjinekologjik “Koço Glliozheni” në të cilin dhuroi disa inkubatorë për foshnjat e këtij materniteti.
- Spitalin Universitar Obstetrikë Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, në blerjen e krevateve specifike profesionale që shërbejnë për sallën e operacionit.
- Projekti “Studim mbi Audiometrinë Vokale” në gjuhën shqipe i aplikuar për herë të parë në Shqipëri.
- Spitalet Rajonale të Vlorës në blerjen e 5 poltronëve për kimioterapi.
- Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” duke mbuluar shpenzimet për blerjen e 15 aparaturave mjekësore.
- Spitalin Rajonal të Durrësit dhe Spitalin Rajonal Shkodër për mbulimin e shpenzimeve për përmirësimin e infrastrukturës së spitalit.



FIBank Albania

- FIBank mbështeti nismën “Dhuroni një lule për Sarandën!”, e cila është një iniciativë afatgjatë mjedisore me misionin e kryesor “Për një qytet të lulëzuar”.
- Gjatë muajit të ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit, mbledhi fonde në mbështetje të një punonjëse të FIBank, e cila po lufton me këtë sëmundje.
- Sponsor i projektit të parë të qendrës sociale të quajtur “MamiCare” për nënat dhe të porsalindurit e tyre në Tiranë. MamiCare Centre është një hapësirë për prindërit e rinj dhe të ardhshëm për të zhvilluar aftësitë e prindërve dhe menaxhohet nga Fondacioni Spitalor Nëna dhe Fëmija.



Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Grupi Intesa Sanpaolo zhvilloi Programin Ndërkombëtar të Kujdesit Shëndetësor (International Healthcare Programme) me qëllim ofrimin e ndihmës më të mirë të mundshme për punonjësit që vuajnë nga sëmundje serioze kritike nga një rrjet i Mjekëve më të Mirë Ndërkombëtarë. Pjesë e përfitimeve të këtij programi janë edhe punonjës të Intesa Sanpaolo Bank Albania.
- Bazuar në ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 dhe VKM 107 9.02.2011 “Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe të funksionimit për Këshillin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe përfaqësuesit e Punëmarrësve”, gjatë muajit mars u zgjodhën 6 përfaqësues të punëmarrësve,





me një mandat 2-vjeçar, me të drejtë rinovimi si dhe 6 përfaqësues të Punëdhënësit për Këshillin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ky Këshill është funksional dhe mbledhet disa herë në vit për të përmirësuar në vijim kushtet e punës.

Raiffeisen

- Reparti i patologjisë në Spitalin Rajonal Berat ka tashmë ambiente të reja, falë mbështetjes që Raiffeisen dha për rehabilitimin e plotë të tij.
- Mbështeti Spitalin Rajonal Krujë, duke bërë të mundur pajisjen e maternitetit të këtij spitali më një aparaturë ekografie. Gjithashtu, një tjetër projekt po kaq i rëndësishëm në mbështetje të shëndetësisë ishte dhe pajisja me disa aparatura e laboratorit të Spitalit Lezhë.
- Mundësoi rikonstrukcionin e plotë të urës lidhëse midis dy pavijoneve në spitalin e Korçës dhe rikonstrukcionin e fasadës në spitalin e Kolonjës
- Me rastin e 1 qershorit, mbështeti fondacionin “Ti je një luledielli”, në organizimin e një feste për fëmijët e spitalit onko-hematologjik Tiranë, ku përveç argëtimit nuk munguan edhe dhuratat që stafi i bankës dhuroi për fëmijët.



Dhurim vullnetar gjaku

Kjo nismë synon të motivojë individët që të dhurojnë gjak rregullisht në mënyrë vullnetare nëpërmjet bankave të mirë-organizuara për dhurimin e gjakut.

Mbështetur nga: Alpha Bank Albania, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Credins Bank, FIBank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen, Procredit Bank, Union Bank.

OBJEKTIVI #4 Arsim Cilësor

Përfshirje në projekte /investim në sektorin e arsimit.

4 kredi të reja të dhëna në vlerën **100.710.000** lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: **38.402.000** lekë

Financim i shpenzimeve të arsimit 231 kredi të reja të dhëna në vlerën

158.957.511 lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: **175.400.000** lekë

Rreth **15.000.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit.

DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

Procredit Bank, në favor të mbështetjes së zhvillimit të stafit të saj, mundësoi pjesëmarrjen në kurse të ndryshme të arsimit të mëtejshëm në akademi, kurse të gjuhëve të huaja dhe trajnime të ndryshme.

Credins Bank nënshkroi marrëveshje me universitetet "Marin Barleti" dhe Universitetin Evropian të Tiranës (JET) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë studentëve, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të paguar tarifat e shkollimit. Falë këtyre marrëveshjeve, studentët nuk paguajnë interesin e kredisë por vetëm pjesën e principalit.

Intesa Sanpaolo Bank Albania, në marrëveshje me ambasadën italiane dhe ambasadën gjermane, certifikoi dhe garantoj aftësinë financiare të studentit ndaj fondeve të depozituara, si dhe siguroi transferimin e fondeve nga studentët, sipas kushteve të paracaktuara nga ambasadat dhe banka. Për më tepër, banka ofron paketa studentore, duke treguar kujdes të veçantë për këtë kategori. Për studentët miratohen terma preferenciale.

Ambasada italiane: Në 3 vitet e fundit kanë aplikuar pothuajse 1396 studentë, ndërsa gjatë vitit 2019 janë 629 studentë. Ambasada gjermane: Në vitet e fundit kanë aplikuar pothuajse 585 studentë, ndërsa gjatë vitit 2019 janë 195 studentë.





PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania mbështeti shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa” në Shkodër në projektin: “Mësohemi dhe edukohemi duke u argëtuar”.

Banka Amerikane e Investimeve

- Mbështeti botimin e librit “Udhëtim ne tri kohë” të profesorit Adrian Civici.
- Më 8–11 korrik, “Albanian Cyber Academy” zhvilloi sesionin e tretë, i cili zgjati 4 ditë për studentët më të mirë të fushës, ndërsa në 12 korrik, për herë të parë u zhvillua trajnimi për rritje kapacitetesh të CSIRT-ve sektoriale nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. ABI Bank ishte pjesë e këtyre aktiviteteve.
- Mbështeti platformën “SchoolMe”, duke i ofruar mundësinë për një vit të shtrihet në të gjithë bibliotekat e rikonstruktura të qytetit të Tiranës si dhe në bibliotekat publike në Korçë, Elbasan, Lezhë, Shkodër. Nëpërmjet platformës “SchoolMe”, lëndët e arsimit 9-vjeçar shpjegohen në shqip nga mësues të regjistruar dhe shoqërohen me video shkencore, filma, imazhe, harta specifike, të gjitha këto në përputhje me kurrikulën zyrtare, në përputhje me kalendarin shkollor.
- Më 13 nëntor, mbështeti organizimin e mbledhjes së 7-të të Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE), e cila u zhvillua nën kujdesin e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE.
- Më 8-10 nëntor, mbështeti organizimin e event-trajnitimit “Rruga Drejt Suksesit” nga Vasil Naçi.

Banka Kombëtare Tregtare

- Universiteti i New York në Tiranë (UNYT) mirëpriti Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) në ambientet e kampusit të tyre për të prezantuar tek studentët projektin më të fundit të bashkëpunimit. Falë kësaj marrëveshjeje, BKT ofron për studentët më të mirë të UNYT 10 bursa studimi dhe 20 praktika mësimore të paguara për çdo vit akademik, Më tej, procesi i rekrutimit finalizohet me punësimin e studentëve.
- Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës (UAMD) organizoni ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP). Bashkëpunimi 12 vjeçar midis BKT dhe FASTIP nxjerr në pah vit pas viti suksesin e këtij sistemi arsimor unik në Shqipëri. Një kënaqësi e veçantë, e dhuruar nga BKT për studentët diplomantë dhe prindërit e tyre për këtë vit 2019, ishte punësimi i 14 studentëve në periudhën korrik - gusht, përpara diplomimit.
- Mbështeti Zyrën Arsimore Kamëz dhe dhuroi mobilie për t’u përdorur në shkolla të ndryshme publike dhe pajisje të reja si 2 PC, 2 laptopë dhe 2 printera.

- Mbështeti Universitetin “Luigj Gurakuqi” në organizimin e një seminary me temë “Sfidat e Zhvillimit Rajonal”.


Credins Bank

- Në Ditën Ndërkombëtare të Kursimit ishte pranë nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Edith Durham” ku u zhvillua një bisedë të këndshme informuese për fëmijët dhe përfshirjen e tyre drejt një kulture kursimi.
- Mbështeti Shkollën e Mesme Profesionale në Kamëz me blerjen e pajisjeve teknologjike për përmirësimin e infrastrukturës së punës.
- Mbështeti forumin “Novacioni në Sistemin Financiar Shqiptar” organizuar me studentët e Universitetit Evropian të Tiranës. Banka Credins prezantoi Bankën Lëvizëse dhe aplikacionin Credins Online në kuadër të digjitalizimit dhe modernizimit të sistemit bankar.
- Mbështeti Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës në organizimin e ceremonisë së diplomimit të studentëve.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Në 29 mars, në bashkëpunim me Junior Achievement of Albania, mbështeti konkursin e zhvilluar mes rreth 30 rinjve të moshave 17-18 vjeç në qendrën “Protik”, ku përfaqësues të shkollave të mesme morën pjesë në aktivitetin “Tregtia Ndërkombëtare - Tregtia midis Shteteve”.
- Në 23 prill, mbështeti Ditën Botërore të Librit dhe të Drejtave Autoriale.
- Në 24 prill, ndihmoi në organizimin e Festës së Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë” në kampusin universitar me rastin e 26 vjetorit të themelimit, si dhe veprimtarinë e Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë” në Shqipëri. Gjatë ceremonisë u vlerësuan me bursa studentët e shkëlqyer dhe u mbajt një banket për të pranishmit.
- Në 25 prill, Banka mbështeti për të dytin vit radhazi Konferencën Studentore “Globalizimi në IN.E.AR deri në limitet e tij”, ku studentët prezantuan punimet e tyre me temë nga ekonomia. Fituesja e çmimit të parë të punimit më të mirë “Strategjia e Planifikimit të Zgjuar”, Norilda Toska, nisi një praktikë mësimore të paguar pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania.
- Në 21 qershor, mirëpriti në zyrat qendrore disa studentë të Universitetit Epoka. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të fokusit që banka ka në edukimin financiar.
- Mbështeti për të dytin vitin radhazi konkursin me tematikën e “Big Data Analysis” të organizuar nga EESTEC Tirana. Projekti u konkretizua përmes një Hackathon, një konkurs në kohë reale ku morën pjesë studentë nga Universitete të Tiranës, orientuar në drejtimet e Inxhinierisë Informatike dhe Shkencave Kompjuterike. Të gjithë finalistëve iu ofrua një intervistë për mundësi punësimi dhe dy prej tyre u përzgjedhën për t’u punësuar në Divizionin e Teknologjisë së Informacionit të Bankës.





- Në 31 tetor, me rastin e Ditës Botërore të Kursimit, Banka iu bashkua për të tretin vit radhazi nismës së suksesshme ndërkombëtare “Art of Saving” (“Arti i Kursimit”) të Grupit Intesa Sanpaolo & Muzeut të Kursimit (Museo del Risparmio), Gallerie d’Italia & Arkivi Historik. Koncepti u krijua nga Muzeu i Kursimit, një laborator multimedial i vendosur në Torino, Itali, i cili i dedikohet edukimit financiar. “Arti i Kursimit” bazohet në metodat e edukimit jo-formal dhe synon t’iu mësojë fëmijëve dhe të rinjve rëndësinë e kursimit, duke përdorur shembuj praktikë nga jeta e përditshme. Gjatë nismës “Arti i Kursimit” që u organizua gjatë periudhës 30 tetor - 5 nëntor 2019, 56 anëtarë të stafit të Intesa Sanpaolo Bank Albania ofruan vullnetarisht sesione për edukimin financiar në 41 shkolla në të gjithë vendin. 1300 fëmijë të moshës 6-10 vjeç, 460 fëmijë të moshës 11-14 vjeç, dhe rreth 350 të rinj nxënës të gjimnazeve të vendit ishin pjesë e kësaj nisme.



Banka OTP Albania në dhjetor 2019, mbështeti konkursin “Eseja më e mirë” organizuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit në Shkodër.

ProCredit Bank kontribui me bazë materiale për shkollën 9-vjeçare në Derven, Krujë. Kjo mbështetje u realizua në bashkëpunim me shoqatën Vizion, një organizatë aktive nëpërmjet projekteve humanitare.

Raiffeisen

- Për të katërtin vit radhazi, vijoi mbështetjen e projektit “Qyteti i Lexuesve”, një projekt që synon krijimin e hapësirave të reja letrare për edukimin e brezave të rinj. Pas bashkëpunimit të suksesshëm me bashkitë e qyteteve Tiranë, Lushnje, Fier, Krujë dhe Divjakë, këtë herë mbështeti iniciativën e Bashkisë Berat, duke bërë të mundur pasurimin e bibliotekës publike me shumë tituj librash të rinj.
- Mbështeti Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, duke bërë të mundur pajisjen me mjete shkollore të fëmijëve nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të.
- Bëri të mundur rikonstrukcionin e plotë të laboratorit të informatikës në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës.
- Mbështeti rikonstrukcionin e plotë të Mediatekës në Universitetin “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, duke iu ofruar studentëve dhe pedagogëve të këtij universiteti një sallë me standarde bashkëkohore për organizimin e aktiviteteve të ndryshme.
- Fëmijët e Kopshtit “Buzëqeshja” në Gjirokastrë e nisën vitin e ri arsimor me mjedise të reja dhe shumë komode, falë mbështetjes që Raiffeisen i dha Bashkisë Gjirokastrë për rikonstrukcionin e plotë të mjedisëve të këtij kopshti.
- Mundësoi pajisjen e laboratorit të informatikës me komp-



juterë në gjimnazin “18 Tetori” në qytetin e Lushnjës.

- Në 9 shtator, mbështeti simpoziumin e dytë ndërkombëtar K-Force 2019. Kjo veprimtari kishte në fokus çështjet aktuale në lidhje me arsimin, shkencën dhe praktikën në fushën e menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive dhe inxhinierisë së sigurisë nga zjarri.
- Mbështeti Zyrën Arsimore Krujë, duke mundësuar pajisjen me libra të bibliotekave në shkollën 9-vjeçare nr. 1 në Krujë dhe në Shkollën e Mesme të Bashkuar Haxhi Qira, Burizanë.
- Në 7 mars, në Ditën e Mësuesit, kontribuoi në organizimin e festimeve për mësuesit në rrethin e Shkodrës, Tepelenës, Gramshit dhe Gjirokastrës.

Banka OTP Albania

- Në 20 nëntor, një grup punonjësish të Bankës OTP Albania u angazhuan në krijimin e një biblioteke për Kopshtin “Beni Ecën Vetë” në Tiranë. Ky grup bleu një numër të konsiderueshëm librash për fëmijët e këtij kopshti si dhe mundësi mobilimin e bibliotekës.
- Ofroi mundësi për të rinjtë që duan të hyjnë në tregun e punës. Më shumë se 100 aplikantë kanë ndjekur programin e praktikës gjatë vitit 2019, 6 prej të cilëve tanimë janë pjesë e stafit të bankës OTP Albania me kohë të plotë.
- Dhuroi artikuj shkollorë dhe jo vetëm, për nxënësit e “Tirana International School”.



Java e Parasë në Shqipëri

Gjatë javës 25-31 mars 2019, Banka e Shqipërisë (BSh) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe ANFE organizuan aktivitete të larmishme, duke synuar përfshirjen e një numri sa më të madh të rinjsh, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi çështje të edukimit financiar. Në Javën e Parasë 2019 u përfshinë aktivisht rreth 4000 nxënës dhe studentë, nga më shumë se 90 shkolla të të gjitha niveleve.

Në kuadër të kësaj jave u zhvilluan konkurse të ndryshme, të cilët u mbështetën nga bankat anëtare.

- Konkursi me temën “Mëso. Kurse. Fito” dhe u mbështet nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT). Në konkurs morën pjesë nxënës të klasave VI të shkollave 9-vjeçare.
- Konkursi me fotomontazhe me temë: “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër: një 0 më shumë bën diferencën”, në të cilën morën pjesë nxënësit e klasave IX të shkollave 9-vjeçare u mbështet nga Credits Bank.
- Konkursi i videos më të mirë me temën “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër” dhe çmimet u mbështetën nga Banka Amerikane e Investimeve.
- Konkursi për esenë më të mirë me temat “Ridenominimi i Lekut: vështrim socio-linguistik mbi një gabim 55-vjeçar” (Dega Gjuhë-Letërsi) dhe “Ridenominimet: shembuj nga historia dhe rasti shqiptar” (Dega Financë-Bankë), u mbështet nga Intesa Sanpaolo Bank Albania.

European Money Quiz. AAB u bë pjesë e konkursit evropian, i cili u organizua për herë të parë në 2018, me qëllim rritjen e kulturës financiare për fëmijët e moshës 13-15 vjeç.

Federata Evropiane Bankare nderoi me një çmim special Shoqatën Shqiptare të Bankave “Mirënjohje të veçantë për Shqipërinë: e vogël, por e shkëlqyer!”

Alpha Bank Albania në bashkëpunim me Organizatën Junior Achievement Albania, mbështeti aktivitetin “Lider për 1 Ditë”. Një student i ekselencës nga gjimnazi u caktua që përgjatë gjithë ditës të shoqëronte një ekspert bankar për të fituar përvojë praktike dhe për t’u sjellë si lider përgjatë gjithë ditës së punës.

OBJEKTIVI #5 Barazi Gjinore

Kredi për SME që drejtohen nga gratë

289 kredi të reja të dhëna në vlerën **1.244.154.000** lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: 63 kredi në vlerën

2.102.518.000 lekë.

Në fund të vitit 2019, bankat kishin **6.362** punonjës, prej të cilëve 600 janë femra në borde dhe role drejtuese.

Rreth **2.220.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit.



MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përshtatja e proceseve të kredisë dhe metodave të huadhënies për të zgjeruar dhënien e kredive për NVM-të e drejtuara nga gratë, për shembull, duke ofruar kredi pa kolateral.

Rritja e përqindjes së grave në bordet e shoqërive dhe rolet drejtuese, dhe investimi në politika dhe programe në mbështetje të grave si fuqi punëtore, si dhe nxitja e organizatave në zinxhirin e vlerave për ndërmarrjen e nismave të ngjashme.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Programe dhe politika që synojnë mbështetjen e gjinisë femërore

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Për nënat që ushqehen me gji parashikohet një leje e paguar në periudha të ndryshme kohore gjatë ditës pas kthimit të tyre nga leja e lindjes. Banka ofron përfitime të zgjeruara të kujdesit shëndetësor për të gjithë punonjësit, të përshtatura për gratë dhe burrat. Për nënat beqare, banka rimbursos kostot e librave të shkollës për fëmijët e tyre. Banka kontribuon në zhvillimin pro-

fesional të ekipit femëror, duke mbështetur tarifat e anëtarësisë financiare në organizatat profesionale (p.sh., Shoqatat e Avokatëve, Instituti i Auditorëve të Brendshëm, etj.).

Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nënshkruan marrëveshjen e re në kuadër të programit të dytë të grave në biznes në Ballkanin Perëndimor, për të përmirësuar qasjen në financim, duke krijuar kredi specifike me interesa më të ulëta dhe paketa produktesh e shërbimesh, duke ofruar edukim të mëtejshëm dhe zhvillim personal, trajnime dhe këshillime nga ekspertët e BERZH & të Bankës. Brenda 2 viteve të para të programit, banka financoi një shumë totale prej 2 milionë euro për 147 gra në sipërmarrje të suksesshme. BERZH vendosi të zgjerojë programin në fazën e dytë me një shumë më të madhe investimi, prej 5 milionë euro, duke synuar përhapjen më të gjerë të këtyre mundësive gjeografikisht dhe për kategori të ndryshme.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania mbështeti NYOU Festival, një aktivitet muzikor ku artistë të njohur nga vende të ndryshme performojnë në Jazz. Të ardhurat nga aktiviteti iu dhuruan “Strehëzës për gra dhe vajza”.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- Mbrëmjen gala të organizuar në Tiranë më 17 maj nga aktivistët e komunitetit LGBT, të cilët janë viktimë të abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës “Streha”, misioni i së cilës është sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psikosociale, aftësisë për jetën, edukimit dhe punësimit për të rinjtë LGBT.
- Strehëzën për gra dhe vajza të dhunuara, një organizatë jofitimprurëse që ushtron funksionin e saj në qytetin e Tiranës. Projekti synoi përmirësimin e mjediseve fizike të Strehëzës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Në 8 mars, ndërmori një fushatë duke uruar përmes rrjeteve sociale Ditën Ndërkombëtare të Gruas. “Mendo në mënyrë të barabartë, ndërto në mënyrë të zgjuar dhe krijo inovacion për ndryshimin!” ishte tema e përdorur nga UN Women duke u përqendruar në mënyra të reja novatore, të cilat mund çojnë përpara çështjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Mbështeti Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për Gruan, organizuar gjatë muajit mars për herë të parë nga UN Women në Shqipëri, me fokus dhunën me bazë gjinore. Dokumentarë dhe filma u mundësuan për publikun falas. Festivali trajtoi tematika sensitive dhe ishte një mundësi e mirë për të reflektuar lidhur me barazinë e roleve dhe të drejtave të grave dhe burrave.
- Në 25 prill, mbështeti Ditën Ndërkombëtare të Vajzave në ICT.



OBJEKTIVI #7 Energji e përbalueshme dhe e pastër

Hua për energjinë e rinovueshme

69 kredi të reja të dhëna në vlerën **1.895.856.000** lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: 255 kredi në vlerën

16.762.894.000 lekë.



MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Aplikimi i ekspertizës financiare ndaj modeleve të çmimit të energjisë, të cilat përbushin tre objektivat e qëndrueshmërisë financiare, efikasitetit të energjisë dhe qasje universale, duke përfshirë veçanërisht shqyrtimin e nevojave për energji të komuniteteve me të ardhura të ulëta.

Nënvizimi i zhvillimeve në fushën e energjisë së rinovueshme, si për shembull impiantet me erë dhe impiantet fotovoltaike me energji diellore, për të përshtatur kalimin drejt një ekonomie gjithëpërfshirëse me nivel të ulët karboni.

Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt dhe me shërbime moderne të energjisë, rritja në mënyrë të ndjeshme e pjesës së energjisë së rinovueshme në kombinimin e energjisë së botës, dhe dyfishimi i normës globale për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Procredit Bank: Sistemi i menaxhimit mjedisor të bankës përbëhet nga tre shtylla: Sistemi i administrimit të brendshëm mjedisor; Administrimi i riskut mjedisor në kredi-dhënie; Promovimi i Kredive Eko.

- Rikonfirmoi certifikatën ISO 14001, standard i njohur

ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor. Në aktivitetet e biznesit, ProCredit Bank kujdeset që aktivitetet e saj të jenë të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit, duke mbrojtur mjedisin dhe parandaluar ndotjen.

- Ndërmori një fushatë të brendshme me fokus rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me çështjet mjedisore. Në baza 3 mujore janë hartuar dhe shpërndarë buletine periodike, dedikuar temave të caktuara, si: reduktimi i mbetjeve plastike, ndërtesat e gjelbra (Green), makinat elektrike, etj.

Union Bank

Në 12 mars 2019, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) organizoi prezantimin e programit GEFF - Lehtësim për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër, i cili ka për qëllim nxitjen e investimeve në energjinë e gjelbër në Shqipëri. BERZH ka nënshkruar një kredi prej 6 milionë euro me Union Bank për zbatimin e këtij programi në vendin tonë. Union Bank krediton individët që dëshirojnë të investojnë në banesat e tyre, duke investuar në projekte që kursejnë energji elektrike dhe ulin ndjeshëm vlerën e faturës së saj.

Stafi i degëve të Union Bank ka zhvilluar një trajnim të specializuar për trajtimin dhe analizimin e çështjeve të huasë së programit GEFF, të quajtur Kursime+, për të përcjellë produktin më qartë dhe më thjeshtë te klientët. Ky produkt u prezantua në edicionin e tretë të panairit të Energjisë Expo & Forum 2019 të zhvilluar në 4 tetor.



OBJEKTIVI #8 Punë dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

Kredi për SME me qëllim nxitjen dhe rritjen e qasjes në shërbimet bankare (pa-
varësisht degës së ekonomisë)

1206 kredi të reja të dhëna në vlerën **18.350.880.000** lekë.

Kredi për turizmin/agroturizmin 88 kredi të reja të dhëna në vlerën

2.256.517.940 lekë.

Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: 94 kredi në vlerën

783.566.000 lekë.

Rreth **2.800.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të
institucioneve për arritjen e objektivit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA


Puna me aktorët kyç për gjetjen e zgjidhjeve praktike,
të cilat do të ndryshojnë prirjen e bankave ndërkom-
bëtare për tërheqjen e shërbimeve bankare përkatëse
për shkak të kuadrit ligjor dhe rregullator.

Zgjerimi i mikrofinancave (kursime, kredi dhe sigurime)
për pronarët e bizneseve të vogla.

Zgjerimi i financave për “shtresën me të ardhura të
pamjaftueshme”, d.m.th. ndërmarrjet e vogla që lindin
nga mikrofinanca, të cilat ende nuk janë në gjendje të
marrin kredi nga sistemi bankar formal.

Sigurimi i praktikave të synuara për të rinjtë me pre-
jardhje nga shtresat e pafavorizuara, me qëllim pro-
movimin e lëvizshmërisë sociale, duke rritur gjithashtu
performancën e shoqërisë përmes rritjes së shumëllo-
jshmërisë së fuqisë punëtore.

Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve financiare ven-
dase për nxitjen dhe zgjerimin e qasjes në shërbimet
bankare, të sigurimeve dhe financiare për të gjithë.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Alpha Bank Albania, Credins Bank, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Fibank Albania

Bankat, në partneritet me Ministrinë e Arsimit, ofrojnë mundësi për kryerjen e praktikave të punës për studentët, disa prej të cilëve u është dhënë mundësia e punësimit në bankë.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Panairt e Punës dhe Studimit,

Alpha Bank Albania, Credins Bank, Intesa Sanpaolo Bank Albania, ProCredit Bank, Union Bank

Bankat mbështesin dhe zhvillojnë programe, të cilat përqendrohen në uljen e nivelit të papunësisë në vend dhe vazhdimisht ofrojnë mundësi punësimi për pozicione të ndryshme në sektorin bankar, si edhe praktika për studentët. Në kontekstin e mbështetjes dhe nxitjes së punësimit, këto banka morën pjesë në lloje të ndryshme panairësh (panairi i punës, panairi i studimit, panairi i karrierës) të organizuara nga Universiteti i Tiranës, Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti i Nju Jorkut dhe UMT .



Alpha Bank Albania dhe **Credins Bank** mbështetën edicionin e dytë të Forumit Ekonomik të Tiranës. Në këtë forum morën pjesë aktorë të rëndësishëm vendas dhe të huaj, të cilët diskutuan rreth sfidave të zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës në Shqipëri dhe rajon dhe rreth praktikave më të mira të zbatuara në vende të tjera të cilat mund të zbatohen në Shqipëri.



Banka Kombëtare Tregtare

- Në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Policisë Fier, dhuroi sistemin e mbajtjes së radhës për institucionin.
- Në mbështetje të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, mundësoi dhurimin e kompjuterëve për stafin e institucionit, në mbështetje të zhvillimit të mëtejshëm teknologjik të tij.

Credins Bank mbështeti:

- Konkursin Kombëtar Ide të Gjelbra, në bashkëpunim me "Partners Albania for Change and Development" ku prezantohen ide novatore për zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe punësimin në Shqipëri.
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në organizimin e panairit "Shqipëria punon tokën", ku fermerë nga i gjithë vendi për dy ditë u mblodhën në Sheshin "Skënderbej" dhe e shndërruan sheshin në një fshat.
- Aktivitetin Mandarina Fest 2019.
- ExpoCity, në organizimin e AGRO-TECH Expo & Forum 2019.



FiBank Albania, më 11 dhjetor, nënshkroi një marrëveshje partneriteti me Fondacionin e Garancisë së Kredisë Rurale në Shqipëri. Ky partneritet bazohet në politikat e KFW, banka gjermane për zhvillim në pronësi shtetërore.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Mundësoi 81 vende për të rinjtë që mund të kryejnë praktikën e punës, duke mbuluar kështu të gjithë vendndodhjen gjeografike të saj.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit pranë Bashkisë së Tiranës, mundësoi punësimin e 4 të rinjve me kontratë me kohë të pjesshme të paguar pranë Bankës.
- Zhvilloi trajnime të dedikuara bazuar në modulin ndërkombëtar të Grupit Intesa Sanpaolo mbi Etikën dhe trajtimin e ankesave etike.
- Në datat 8-12 korrik, organizoi një trajnim të veçantë gjatë aktivitetit Akademia Kibernetike Shqiptare e organizuar nga AKCESK për stafin e Teknologjisë së Informacionit dhe stafin e Sigurisë së Teknologjisë së Informacionit. 2 përfaqësues të Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (AKCESK) trajnuan punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania në mjediset e qendrës Protik.
- Në 11 shtator, në bashkëpunim me Confindustria Albania, zhvilloi pranë qendrës së trajnimeve të bankës në Laprakë një trajnim me temë “Komunikimi strategjik”.
- Në 15-16 mars, mbështeti AGRO-TECH Panair & Forum si Silver Partner, pranë ambienteve të Expocity.
- Në 28 prill, mbështeti Ditën Botërore të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë me fokus në promovimin e sigurisë shëndetit dhe integritetit.
- Gjatë muajit gusht 2019, hapi degën e re në qytetin e Sarandës. Në vijim të ofrimit të shërbimeve e produkteve novatore, Banka përmirëson rrjetin e saj të degëve.



Raiffeisen mbështeti qendrën studentore “ABC Tirana Club” në projektin “Shit dhe bli vetëm në monedhën kombëtare, Lek”.

Union Bank nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në programet e saj të internshiptit. Ajo organizon çdo vit programe internshipti në disa departamente/degë të Union Bank, për studentët me mesatare të lartë të ciklit Bachelor ose Master për një periudhë 3-6 mujore. Gjatë vitit 2019, Union Bank iu ka dhënë mundësinë e zhvillimit të praktikës 53 studentëve, ku 12 prej tyre në fund të programit trajnues janë punësuar pranë Bankës dhe një pjesë tjetër janë në proces për t’u bërë pjesë e Union Bank.

Në 14 qershor, Union Bank dhe Kolegji Universitar “Luarasi” njoftuan zyrtarisht, bashkëpunimin midis tyre për mundësimin e programeve të praktikës për studentët e universitetit. Marrëveshja midis dy institucioneve u nënshkrua nga z. Gazmend Kadriu, CEO i Union Bank dhe Prof.Dr. Et’hem Ruka, Rektor i Kolegjit Universitar “Luarasi”.

OBJEKTIVI #9 Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

Kredi për sektorin e transportit; infrastrukturës së komunikimit

134 kredi të reja të dhëna në vlerën **2.170.000.000** lekë .

Portofoli kredisë në fund të vitit 2019: 114 kredi në vlerën

3.278.417.782 lekë.

Rreth **20.335.000** lekë mbështetje financiare për teknologjinë e informacionit (në institucione të ndryshme)

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Rritja e financimit afatgjatë për partneritetet publike-private në sektorin e transportit, energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës së komunikimit për të kontribuar në zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve me aftësi ripërtëritëse.

Sigurimi i investimeve në infrastrukturë në sferën e influencës përbën ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta, grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara (përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).

Rritja e qasjes së ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, duke përfshirë kreditë e përballueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirin e vlerave dhe në tregje.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive rezervë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptim më të gjerë të teknologjive të pastra dhe të shëndosha në aspektin mjedisor dhe të proceseve industriale, në pajtim me të gjitha vendet që veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse.





DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania

- Përgjatë gjithë vitit, ofroi mbështetjen e saj për institucione të ndryshme publike me dhurim asetesh të Bankës si kompjuterë, printerë, skanera, fotokopje si dhe rikonstrukcione në ambientet e administratave.
- Mbështeti Bashkinë Mat në rikonstrukcionin e stadiumit të qytetit.

Banka Amerikane e Investimeve

- Në 25-27 shtator, mbështeti Tirana Tech Open, një organizim multidimensional realizuar për nxitjen e novatorizmit dhe krijimtarisë në sektorin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
- Edu Zone, Bootcamp në shërbim të rinjve të pasionuar pas teknologjisë dhe aplikimeve të saj, objektiv i së cilës është rritja e njohurive profesionale. Në një eksperiencë tre ditore, nxënës të shkollave profesionale të grup moshës 14-16 vjeç ndoqën praktikat e drejtuara nga mentorë të dedikuar.



Credins Bank ka investuar dhe mbështetur aktivitete dhe projekte për përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë në shumë institucione që ofrojnë shërbime për komunitetin dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies njerëzore. Konkretisht:

- Dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: Fondacioni Firdeus dhe Spitali Rajonal Vlorë.
- Mbështeti Bashkinë Tiranë në restaurimin e lulishtes dhe krijimin e këndit të ri të lojërave pranë stadiumit "Arena Kombëtare".
- Mbështeti Repartin Ushtarak Zall Herr në blerjen e materialeve të rëndësishme për mbarëvajtjen e punës.
- Dhuroi pajisje kompjuterike dhe sisteme teknologjike në përmirësimin e kushteve të punës për Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Vlorë.
- Mbështeti Spitalin Rajonal të Peshkopisë duke dhuruar pajisje teknologjike.
- Mbështeti Drejtorinë Arsimore në Tiranë dhe Fier duke dhuruar materiale të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit, ku vlen të përmenden sistemet e reja kompjuterike, pajisje fotokopje, etj.
- Mbështeti Shtëpinë e Pushimit Durrës në blerjen e materialeve të nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës.
- Mbështeti Komisarriatin e Policisë Elbasan duke dhuruar një sistem të ri kondicionimi.



- Mbështeti Bashkinë Mat për të përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet e ambienteve të stadiumit sportiv.
- Mbështeti Spitalin “Ihsan Cabej” dhe Komandën e Forcave Tokësore, duke mbuluar shpenzimet për restaurimin e ambienteve.
- Mbështeti Qarkun Dibër, Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, Qendrën Shëndetësore Nr. 1 Kodër Kamëz, Drejtorinë Arsimore Fier dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore Fier, duke mbuluar shpenzimet për restaurimin e mjediseve të institucioneve si dhe blerjen e pajisjeve kompjuterike në disa prej tyre.
- Mbështeti ICTSmedia, Uplift Albania, akseleratorin më të madh në vend, i cili do të vihet në funksion të inovacionit dhe mbështetjes së vazhdueshme të startup-eve më novatore në Shqipëri, Kosovë dhe Rajon.

Në 10 tetor, në kuadër të muajit Evropian të Sigurisë Kibernetike, Fibank Albania sponsorizoi CyberCon Albania, e cila u organizua nga Instituti Kanadez i Teknologjisë në bashkëpunim me ICT Academy dhe Ecronex Media.


Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Në 24-27 tetor në Dubai, mbështeti Skuadrën Shqiptare të Robotikës, e cila përfaqësoi vendin tonë në FIRST Global Challenge, ku 5 të rinj të talentuar, prezantuan robotin e krijuar prej tyre dhe arritën deri në fazën finale ku fituan vendin e dytë për çmimin “Clara Barton Award for Helping Hands”.
- Në 30 mars, mbështeti AIESEC në Shqipëri në organizimin e SpringCo2019 (Konferencë Studentore).
- Në 21 prill, mbështeti Ditën Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit.

Procredit Bank gjatë vitit 2019 ofroi për të gjithë bizneset klientë të bankës një platformë të përmirësuar e-banking, duke i dhënë gjithnjë e më tepër mundësi biznesit që të plotësojë nevojat bankare nga zyra apo mjediset e tyre të biznesit.

Raiffeisen

- Vijoi traditën e saj në mbështetje të të rinjve në fushën e teknologjisë, informacionit dhe komunikimit, duke mbështetur për të shtatin vit radhazi aktivitetin Albanian ICT Awards.
- Mbështeti edicionin e parë të Tirana Tech Open 2019, një veprimtari unike multidimensionale, e cila kishte në fokus nxitjen e inovacionit dhe krijimtarisë në sektorin e





shërbimeve të teknologjisë.

- Në datë 24 prill, mbështeti konferencën InfoCom, e cila këtë vit shënoi edicionin e saj të 10-të, InfoCom X - the Anniversary.
- Për të katërtin vit radhazi, mbështeti konferencën e marketingut digjital AllWeb.

Union Bank, në 11 dhjetor 2019, nënshkroi një marrëveshje me Fondin e Garancisë së Kredisë Rurale (RCGF) me synim zgjerimin dhe lehtësimin e qasjes në financa për sipërmarrësit dhe fermerët shqiptarë.

BERZH nënshkroi Marrëveshjen e Ndarjes së Riskut me Union Bank. Shoqëritë shqiptare do të fitojnë qasje më të mirë në financa, falë marrëveshjes për ndarjen e rrezikut në vlerën 30 milionë euro.



OBJEKTIVI #10 Zvogëlim i Pabarazive

Rreth **7.000.000** lekë mbështetje në ndihmë të shtresave të varfra / me aftësi të kufizuara / kundër diskriminimit / në nevojë të popullsisë.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përdorimi i teknologjive të reja, të tilla si shërbimet e pagesave nëpërmjet transfertave me celular për të krijuar modele operative dhe shpërndarëse më efektive dhe efektive për tregjet e reja, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare.

Zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja, të tilla si të dhënat me kapacitet të madh dhe informatika në renë kompjuterike "cloud" për të fituar njohuri të reja që përmirësojnë analizat e riskut dhe të mundësive.

Sigurimi i mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive të rezultateve, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjisllacionit, politikave dhe masave të duhura në këtë drejtim.

Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve. Lehtësimi i migrimit të drejtë, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë.

Alpha Bank Albania bashkëpunoi me World Vision Albania dhe mbështeti programin "Tungjatjeta" me anë të së cilit ekipe specialistësh ofrojnë terapi në shtëpitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonën e Librazhdit.

Alpha Bank Albania dhe **Union Bank** mbështetën **Down Syndrome Albania** në hapjen e qendrës PRO PAK, e cila ofron shërbime të ndryshme terapeutike individuale dhe në grup për 100 fëmijë me aftësi ndryshe.

Fëmijët e Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat" edhe këtë fundvit festuan së bashku me stafin e **Bankës Kombëtare Tregtare**.





Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Pjesëmarrja e 35 punonjësve të bankës në Maratonën e Tiranës shërbeu si një kontribut i drejtpërdrejtë për mbështetjen e fushatës së UNHCR “2 billion KM to safety” në mbështetje të refugjatëve.
- Për të rritur ndërgjegjësimin mbi këto problematika, prezantoi një komunikim me klientët dhe publikun përmes ekraneve të ATM-ve, footer në shkëmbimin e email-ve, faqes së internetit dhe faqeve zyrtare të bankës në mediat sociale.

Në 16-21 shtator, **Raiffeisen** mbështeti edicionin e 14-të të “Festivalit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri”. Ky festival, nëpërmjet artit, synon të rrisë ndjeshmërinë ndaj temave me karakter shoqëror, barazinë gjinore, tolerancën fetare, etj.

Tirana Bank ofroi mbështetjen e saj për fëmijët e Qendrës së Zhvillimit të Autizmit në qytetin e Gjirokastrës. Nisma e marre konsistonte në blerjen e disa librave mbi zhvillimin e fëmijëve, vegla didaktike, lodra të personalizuar, etj. për 43 fëmijë të Qendrës së Zhvillimit të Autizmit.

UBA

- Banka u gjend pranë njerëzve në nevojë, Shoqatës së Jetimeve dhe Shoqatës së të Verbërve gjatë muajit të Ramazanit. Banka shpërndau rreth 1140 shporta ushqimore në shumicën e qyteteve të Shqipërisë dhe u organizuan aktivitete argëtuese me fëmijët e stafit.
- Në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë sponsorizoi aktivitetin ku morën pjesë rreth 300 fëmijë jetimë. Ky aktivitet u zhvillua në fushat multisportive të Liqenit Artificial të Tiranës në muajin prill.
- Gjatë muajit mars, Banka mbështeti financiarisht familje dhe individë në vështirësi ekonomike për jetesë ose për të përmbushur nevoja shëndetësore.

Ashtu si çdo vit, bankat patën kënaqësinë të bashkëpunojë me Down Syndrome Albania dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë. Në këtë kuadër, Banka Kombëtare Tregtare, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Procredit Bank dhe Union Bank kontribuuan në blerjen e kartolinave të fundvitit pranë këtyre fondacioneve, si dhe kanë mbështetur veprimtaritë e organizuara në “Ditën Botërore të Sindromës Down”, 1 qershorit dhe festave të fundvitit.



OBJEKTIVI #11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

Hua për shtëpi efiçente (përdorimi më i mirë i energjisë, izolimi, ngrohja, kursimi i energjisë elektrike, etj.)

618 kredi të reja të dhëna në vlerën **2.461.253.000** lekë .
Portofoli i kredisë në fund të vitit 2019: 91 kredi në vlerën **1.622.130.000** lekë.

Rreth **58.080.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Vendosja e bashkëpunimit mes palëve të interesit në qytet për të analizuar dhe rritur rezistencën e sistemeve të ndërvarura, si për shembull infrastruktura e transportit dhe shërbimet komunale, të cilat përbëjnë themelet e rezistencës së aseteve individuale.

Edukimi i pronarëve të shtëpive dhe bizneseve për materialet dhe teknikat e ndërtimit rezistente ndaj motit, dhe ofrimi i stimujve për zbatimin e tyre.

Shpërndarja e informacionit për rrezikun, me qëllim informimin lidhur me legjislacionin e qeverisë mbi zonimin e tokës dhe kodet e ndërtimit në praktikë.

Përforsimi i përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.


Sigurimi i qasjes universale në hapësira të sigurt, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, banka punësoi





3 persona me aftësi të kufizuara.

- 75,8% e degëve të bankës janë të aksesueshme nga përdoruesit e karrigeve me rrota.

Alpha Bank Albania mbështeti festën e verës dhe gëshenjave, një festë që promovon prodhimet tradicionale të qytetit të Pogradecit.

Banka Amerikane e Investimeve

- Falë investimit të bankës, në Parkun e Liqenit u përrua Moli i Dashurisë. Investimi më i ri është shëtitorja e re buzë liqenit dhe molit të varkave me dhe pa vela dhe kanoeve, si një nevojë për ta kthyer zonën në një hapësirë rekreative shumëfunktionale.
- “100 fshatrat” është një bashkëpunim i bankës me Revistën Bordo. Gjithçka për traditat dhe zakonet e ilustruara me foto përmes faqeve të dedikuara në revistën e printuar dhe në faqen online të revistës www.bordo.al.
- Sponsor i përgjithshëm i Ditës së Verës 2019.
- Në vijim të mbështetjes së nismave që promovojnë vullnetarizmin dhe mbrojtjen e natyrës, banka përkrahu iniciativën e Fondacionit OPTIMA për pastrimin e plazhit dhe pyllit të Darëzezës në Fier.
- Një nga sponsorët e projektit Smile Albania. 15 pika informacioni, 9 pika kufitare dhe 1000 të rinj mirëpritën turistët, duke dhënë informacione mbi vendin. Çdo ditë u shoqërua me veprimtari argëtuese të shpërndara si në bregdet ashtu dhe në zonat malore.
- Mbështeti Festivalin JAZZ në Shkodër, i cili bashkon çdo vit muzikantë të njohur nga Shqipëria dhe bota.
- Në 24-28 korrik, mbështeti për të dytin vit festivalin Muzika Internacionale në Korçë (MIK),.
- Në 14-18 gusht, mbështeti Festën e Birrës në Korçë,.
- Mbështeti për të tretin vit radhazi Muzeun e Stilit Ethno Vibe, i cili erdhi sërish për Ditën e Trashëgimisë Kulturore në 28 shtator në rrugicat e Pazarit të Korçës.



Banka Kombëtare Tregtare

Vijon mbështetjen e saj për institucionet publike në kuadër të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të institucioneve.

- Sponsorizoi blerjen e dyshekëve për Shkollën e Trupës Bunavi.
- Financoi përmirësimin e mjediseve të DAR Vlorë dhe DAR Selenicë.
- Dhuroi kompjuterë për drejtorinë e S.U.O.GJ. Koço Gliozheni.
- Sponsorizoi blerjen e materialeve të ndryshme për Forcat Tokësore.

“Financimi pa interes për të pastrehët nga tërmeti” është një produkt që BKT ka për qëllim t'i ofrojë individëve të prekur nga tërmetet e ndodhura në Shqipëri në 21 shtator dhe 26 nëntor 2019. Ky produkt ofrohet në formën e blerjes së një pasurie të patundshme me një çmim të rënë dakord ndërmjet palëve, përkatësisht ndërmjet shitësit dhe blerësit, ku klienti bie dakord të përdorë pronën në këmbim të qirasë për një afat të përcaktuar, dhe këtë pagesë në formë qiraje qira-marrësi ia paguan bankës.

FIBank Albania

- Për të rritur ndërgjegjësimin për përdorimin më të mirë të parasë, në gusht 2019 FIBank prezantoi në Media Sociale lojën “Unë Dua”. Loja ka rezultuar e suksesshme në arritjen e shumicës së # 11 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Në 1 tetor, në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, FIBank uroi të gjithë klientët e saj duke kredituar fonde në llogaritë e tyre të pensioneve dhe duke u uruar atyre shëndet të mirë dhe mirëqenie.

Raiffeisen

- Mbështeti Bashkinë e Tiranës në projektin “Karta e Studentit”, duke ofruar edhe një paketë me shërbime falas për të gjithë të rinjtë që kanë një kartë studenti. Kjo marrëveshje shton gamën e shërbimeve dhe produkteve që studentët e pajisur me kartën e studentit do të përfitojnë falas apo me tarifa të reduktuara.
- Mbështeti Ministrinë e Kulturës për fazën e dytë të rehabilitimit të godinës së Teatrit të Operës dhe Baletit.
- Mbështeti Bashkinë Fier në realizimin e projektit “Ndërtimi i sistemit të konferencës dhe regjistrimit audio” në sallën e Këshillit të Bashkisë Fier.
- Në Ditën Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit për Autizmin, mbështeti Fondacionin Fëmijët Shqiptarë në publikimin e një manualit të rëndësishëm terapeutik për prindërit, në formatin libër dhe DVD.
- Mbështeti Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë, ku mundësoi pajisjen e 5 shkollave 9 vjeçare në kryeqytet me nga një dhomë relaksi, të cilat do t'u vijnë në ndihmë fëmijëve me aftësi ndryshe që janë integruar në këto shkolla.
- Në 2 prill, mbështeti Edicionin e dytë të Ballos Vjeneze, organizuar në Pallatin e Kongreseve. Një pjesë e të ardhurave të mbledhura nga ky event i shkuan Fondacionit “Ti je një luledielli”.
- Mbështeti Bashkinë Himarë në organizimin e “South Outdoor Festival”, i cili erdhi në edicionin e 3-të me plotë





4 ditë aktivitete.

- Mbështeti Qendrën “Act for Society” në zbatimin e projektit “Power Up Community 2”. Ky projekt kishte në fokus nxitjen e të rinjve nga zona të ndryshme të Shqipërisë, për të dhënë kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë nëpërmjet ideve të tyre inovatore.
- Mbështeti projektin social-kulturor “E Ardhmja dhe Shpresa”, me fokus promovimin e vlerave artistike të fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet këngëve dhe valleve.
- Në 7-13 korrik, mbështeti edicionin e 17-të të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit të Butrintit “Summer Festival”.
- Mbështeti Festivalin Multi Kulturor Berat, për të gjashtin vit radhazi.
- Mbështeti organizimin e edicionit të 9-të të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë në qytetin e Pogradecit.
- Mbështeti Bashkinë Tiranë në projektin e pajisjes së sheshit “Emil Le Grand” me dy terrene të reja sportive.
- Mbështeti Triathlon Tirana në edicionin e dytë, duke e kthyer liqenin e Farkës në një destinacion sportiv.
- Mbështeti nismën e Shoqatës Tenis Tirana, e cila trajnon dhe edukon rreth 1200 fëmijë nga 3 shkolla, duke treguar edhe njëherë mbështetjen që ne i japim sportit.
- Mbështeti Shoqatën Sportive Minifutboll Tirana, për realizimin e Kampionatit të Futbollit të sallës 2019 të zhvilluar midis të rinjve të grup-moshave të ndryshme.
- Mbështeti Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar për fazën përgatitore të sportistëve për pjesëmarrjen në Lojërat Olimpike në Tokyo.
- Mbështeti fazën përgatitore të stërvitjes së sportistes Luiza Gega për pjesëmarrjen e saj në Lojërat Olimpike.

Banka OTP Albania mbështeti edicionin e 3-të të ZA Fest. Ashtu si edhe edicionet e mëparshme, iu rikthyen këtij aktiviteti midis Bjeshkëve artistë të mirënjohur, të ftuar edhe artistë të tjerë të huaj për të performuar artin e tyre unik.

Tirana Bank

- Në bashkëpunim me UNDP dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, mbështeti projektin i cili prek dy çështje të ndryshme si ndryshimi i klimës dhe promovimi i riciklimit të plastikës.
- Në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, sponsorizoi krijimin e një parku lojërash në zonën e Saukut.

OBJEKTIVI #12 Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

Hua me këtë destinacion në vlerën **49.500.000** lekë dhe shuma e papaguar **155.100.000** lekë.

Rreth **80.000.000** lekë kontribut në menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve natyrore.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Zhvillimi i modeleve të reja për vendosjen e çmimeve për nxitjen e një jete më të qëndrueshme.

Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzimit eficient të burimeve natyrore.

Ulja në mënyrë të konsiderueshme e prodhimit të mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.

Nxitja e shoqërive, veçanërisht shoqërive të mëdha dhe ndërkombëtare, për miratimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.

Sigurimi që njerëzit të kenë në çdo vend informacionin dhe sensibilizimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës, në harmoni me natyrën.


Alpha Bank Albania

Gjatë vitin 2019:

542 kg letër e konsumuar që rezulton në 484 kg letër të ricikluar.

Nga riciklimi i letrës janë kursyer:

- 1450 kg dru
- 15.341 litër ujë
- 3159 kw energji
- 84 kg CO2 gjatë prodhimit





Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Rinovimi i fasadës së zyrave qendrore
- Rindërtimi i 4 Degëve dhe një Dege të re në qytetin e Sarandës
- Përmirësimi i infrastrukturës energjetike dhe elektrike

*Në rinovimin e mjediseve respektohen energjia e gjelbër, interneti, tabletat, ndriçimi i udhëhequr dhe standardet e OH&S (rampa, dalja e emergjencave, etj.)

Kontribut në zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve përmes parandalimit, zvogëlimit, riciklimit dhe ripërdorimit

Letër e certifikuar: e qëndrueshme ndaj mjedisit	26,012 KG
Mbetje të riciklueshme: letër dhe karton	3426 KG
Mbetje të riciklueshme: paketime	770 KG
Mbetje jo të riciklueshme: fishekë, shirita dhe film	135 KG
Mbetje jo të riciklueshme: pajisje zyrash	820 KG
Mbetje jo të riciklueshme: mbetje të tjera jo të rrezikshme	26.450 KG
Mbetje të rrezikshme: bateri plumbi	305 KG



OBJEKTIVI #13 Veprim për Klimën

Rreth **11.712.000** lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Investime në – dhe/ose rritje të financimit për zbutjen e rrezikut klimatik, qëndrueshmërinë klimatike dhe adaptimin klimatik, duke përfshirë hua shtesë dhe instrumente të kapitalit.


Marrja e masave për matjen, zvogëlimin dhe raportimin e ekspozimit klimatik dhe progresit të veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike, me vijimin e rritjes së nivelit të transparencës dhe përputhshmërisë së raportimit në të gjithë sektorin e industrisë.

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Integrimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe planifikime kombëtare. Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, adaptimi, zvogëlimi i ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Intesa Sanpaolo Bank Albania promovoi tek punonjësit dhe klientët e saj:

- 22 prill, Dita Ndërkombëtare të Tokës.
- 16 shtator, Dita Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit.
- 30 mars, nisma globale “Ora e Tokës”.
- 5 qershor, Dita Botërore të Mjedisit - Banka ndërmori një iniciativë një-javore për rritjen e ndërgjegjësimit për të gjithë kolegët dhe klientët e saj përmes kartolinave të fokusuara në përcjelljen e mesazheve rreth ndikimit që ajri i ndotur ka sot në shëndetin e njeriut dhe në mjedis #BeatAirPollution. Kolegëve iu shpërndanë informacione





one më të detajuara rreth politikave të mjedisit dhe në fund ata morën pjesë në një QUIZ me pyetje rreth kësaj tematike. Fituesit e kësaj fushate u ftuan nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës në një darkë të veçantë. Komunikimi me klientët dhe publikun u krye përmes ekraneve të ATM-ve, footer në shkëmbimin e email-ve, faqes së internetit të bankës, faqeve zyrtare të bankës në mediat sociale.

- 21 mars, Dita Ndërkombëtare të Pyjeve. Mëso të duash pyjet! Banka shpërndau fushatën e UN në kanalet e saj të medias sociale.

Banka ProCredit aplikon një sistem të mirëfilltë të menaxhimit mjedisor, i cili përfshin marrjen e masave për minimizimin e ndikimit negativ në mjedis që mund të shkaktohet si nga operacionet e saj të brendshme, ashtu edhe të jashtme (klientë, partnerë, etj.). Si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme është arritur të reduktohet përdorimi i 4750 litra në vit krahasuar me një vit më parë dhe reduktimi i 12.500 kg emetim dyoksid karboni. Ky reduktim ka ardhur si pasojë edhe i përdorimit të 9 makinave ekologjike (elektrike dhe hibride).

Raiffeisen

- Prej më shumë se 10 vitesh jep kontributin e vazhdueshëm në çështjet mjedisore dhe veçanërisht në pastrimin e zonave bregdetare. Edhe këtë vit, në bashkëpunim me Forumin e Mendimit të Lirë, Banka zhvilloi disa akcione për pastrimin e zonave bregdetare nga papastërtitë. Një kontribut të veçantë dha edhe stafi i bankës.
- Më shumë hapësira të gjelbra në kryeqytet dhe kjo falë mbështetjes që banka i dha Bashkisë së Tiranës në nismën e saj për pyllëzimin e Tiranës, duke bërë të mundur mbjelljen e 500 pemëve përgjatë rrugës dytësore në autostradën Tiranë-Durrës.
- Mbështeti Universitetin Bujqësor të Tiranës duke bërë të mundur rehabilitim e plotë të kopshtit botanik në kete universitet. Ky projekt, përveç se shton hapësirat e gjelberta, ju vjen në ndihmë edhe studenteve për të kryer praktikat mësimore.
- Në kuadër të përmirësimit të kushteve të qytetit, sidomos në periudhën e turizmit, mbështeti Bashkinë e Përmetit për pajisjen e parkut të qytetit me stola.

OBJEKTIVI #14 Jeta nën ujë

Hua për peshkimin (rritje e peshkut, mjete peshkimi, etj.)

19 kredi të reja të dhëna në vlerën **115.722.000** lekë .

Portofli i kredisë në fund të vitit 2019: 24 kredi të reja në vlerën

373.891.300 lekë.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Minimizimi dhe trajtimi i ndikimeve të acidifikimit të oqeanëve, duke përfshirë bashkëpunimin shkencor të të gjitha niveleve.

Rregullimi në mënyrë efektive i mbledhjes së prodhimit dhe ndalimi i mbipeshkimit, peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar dhe praktikave shkatërruese të tij. Zbatimi i planeve të menaxhimit të bazuara në rezultate shkencore, në mënyrë që të ruhen rezervat e peshkut për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivelet që mund të prodhohet maksimumi i qëndrueshëm, siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike.

Ruajtja e të paktën 10 përqind të zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, të bazuara në informacionin më të mirë shkencor të disponueshëm.



OBJEKTIVI #17 Partneritet për Objektivat

Rreth **50.000.000** lekë mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme për arritjen e objektivit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Forcimi i lidhjes mes krijimit të vlerave të korporatave dhe shoqërisë dhe harmonizimi i strategjisë së krijimit të vlerës së organizatës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesëmarrja në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.

Zhvillimi i një sërë objektivash të industrisë së shërbimeve financiare të përafuara me OZHQ dhe harmonizimi i strategjisë së korporatave me ato objektiva, me qëllim optimizimin e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm.

Bashkëpunimi me shoqëritë e tjera të shërbimeve financiare dhe palët e interesit për të ofruar perspektiva të industrisë për qeveritë, politikë-bërësit, ligjvënësit dhe rregullatorët, mbi ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kuadrit ligjor, rregullator dhe tatimor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Në ndihmë të pasojave të tërmetejeve

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) u gjend pranë familjeve në nevojë për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmetet e vitit 2019.

- Në shtator 2019, industria bankare i dhuroi Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile një shumë prej 10 milionë lekë, e cila iu bashkua Fondit të Solidaritetit të Emergjencave Civile në mbështetje të banorëve për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në prefekturën e Korçës.



- Pas ngjarjeve fatkeqe dhe vdekjeprurëse të ndodhura në 26 nëntor, si një mbështetje konkrete dhe efektive, në zbatim të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, AAB dhuroi shumën prej 200.000 (dyqind mijë) euro, e cila u depozitua në llogarinë e veçantë të hapur dhe administruar nga qeveria shqiptare. Në të njëjtën kohë, AAB bashkëpunoi me institucionet përkatëse dhe rregullatorët për t'u siguruar që përfituesit e masave të përmendura nuk do të jenë subjekt i ndonjë ndryshimi në klasifikimin e tyre të ecurisë së shlyerjes së kredisë.

Bankat anëtare hoqën tarifat dhe komisionet e aplikuara për transaksionin financiar (vendas dhe ndërkombëtar) për transferimin e fondeve në favor të viktimave të tërmetit.

Anëtarët e AAB-së kanë dhënë edhe kontribute individuale bazuar në rregullat dhe politikat e tyre.

Alpha Bank Albania

- Organizoi aktivitetet festiv dhe mundësoi dhurata për më shumë se 80 fëmijë të akomoduar në hotelet e qytetit të Durrësit.
- Mbështeti koncertin e bamirësisë Ti nuk do të jesh kurrë vetëm duke blerë bileta të tij.
- Me mbështetjen e Grupit Alpha Bank u transferuan fonde në llogarinë e fondeve të emergjencës ku u transferua gjithashtu edhe fondi i planifikuar për shporta festive për bashkëpunëtorët.
- Nisma të tjera u ndërmorën edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të Bankës për stafin e prekur.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti Dhomën Amerikane të Tregtisë në Tiranë në organizimin e ceremonisë me rastin e festës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania ndërmori menjëherë masa konkrete për të ardhur në ndihmë familjeve të prekura.

- Punonjës të degëve Fier dhe Lezhë dhuruan ndihma për familjet e prekura nga tërmeti që në momentet e para të situatës emergjente.
- Shumë familje të SOS Fshatrat e Fëmijëve u ndihmuan me pako ushqimore të mbledhura në bashkëpunim me FoodBank Albania nga vetë punonjësit e bankës.
- Në llogaritë e hapura për mbledhjen e fondeve për të dëmtuarit nga kjo fatkeqësi natyrore, punonjësit e bankës kontribuuan edhe vullnetarisht me anë të donacioneve monetare.





Stafi i **Raiffeisen**, nëpërmjet nismës “RaiffeisenpërShqipërinë”, iu gjendet pranë familjeve të lënduara nga tërmeti duke dhuruar ushqime, veshmbathje, batanije dhe ndihma të tjera të nevojshme për të kaluar situatën e vështirë pas tragjedisë natyrore që preku vendin më 26 nëntor 2019.

Tirana Bank

Dhuroi disa objekte në ndihmë të familjeve të prekura.

- Apartamente dhuruar Entit të Banesave.
- Tokë bujqësore dhuruar Bashkisë Krujë në zonën e rindërtimit në Thumanë.
- Në bashkëpunim me Fondacionin “Fundjavë Ndryshe” ka dhuruar një apartament 73 m2 në Golem, Kavajë.

Alpha Bank Albania dhe **Banka Amerikane e Investimeve** mbështetën Konferencën e 41-të Ndërkombëtare të Komisionarëve të Mbrojtjes së të Dhënave të Privatësisë. Ky është forumi më i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të autoriteteve botërore mbikëqyrëse të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, ku morën pjesë më shumë se 700 delegatë nga e gjithë bota.

Credins Bank

- Sponsorizoi Dhomën Amerikane të Tregtisë në organizimin e Ditës së Falënderimeve.
- Mbështeti Zyrën Vendore Arsimore Shkodër në zhvillimin e aktivitetit të fundvitit.

ProCredit Bank mbështeti zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të “Tetori Gjerman”. Nën frymën e kulturës gjermane, “Tetori Gjerman 2019” me moton “Gur, gur bëhet URË”, erdhi me një sërë aktiviteteve, si: teatër, ekspozita, filma, takime dhe diskutime të ndryshme, të cilat u shfaqën për publikun gjatë gjithë muajit tetor 2019.

Intesa Sanpaolo Bank Albania në Ditën Botërore të Ujit 2019, më 22 mars, shpërndau fushatën e UN në kanalet e saj të medias sociale. Tema ishte “Askush nuk lihet prapa”, çka është një nga objektivat kryesorë për një zhvillim të qëndrueshëm.



Banka OTP Albania mbështeti ceremoninë e festimit të Ditës Kombëtare të Francës, në datë 14 korrik 2019, në Pallatin e Brigadave.




Rreth **97.920.000** lekë mbështetje të veprimtarive në fushën e artit, kulturës dhe sportit.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- Klubin Sportiv “Studenti” si sponsori kryesor i të gjitha ekipeve sportive të klubit.
- Koncertin e kantautorit Ermal Meta dhe grupit “GnuQuartet”, organizuar në 4 mars në sheshin “Skënderbej”.
- Spektaklin e kulinarisë “Gjyshet milionere”, transmetuar në RTSH 1.
- Programin e “E Diell” në Top Channel, si sponsor i përgjithshëm.
- Programin “Familja në Klan TV”, si sponsor i përgjithshëm.
- Programin argëtues “Soiree”.
- Emisionit radifonik në Radio Tirana “Dyqani i Lagjes Sime”, si sponsor i përgjithshëm.
- Radio-Novela humoristike në Radio Tirana.
- Hostel by Anabel 2, prodhim i Anabel Entertainment.
- Turin e koncerteve Tinguj Kinemaje të Orkestrës Simfonike të RTSH-së.
- Rally Albania 2019, si partner zyrtar.
- Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit të Kukullave, si sponsor i përgjithshëm.
- Në 8 qershor, muzikalin “ANNIE”, organizuar në Arturbina, si sponsor i përgjithshëm.
- Në 19-20 prill, Festivalin Ndërkombëtar të Vokalit Operistik “Maria Kraja”, në edicionin e tij të 17-të, në Qendrën Kulturore të Katedrales Orthodhokse në Tiranë.
- Në 23-24 prill, koncertin e dhënë nga Olen Çezari, me grupin e tij “International Clandestine Orchestra” në Pallatin e Kongreseve, si sponsor i përgjithshëm.
- Koncertin e grupin Ritfolk. ABI Bank risolli në skenë të bashkuar artistët.
- Rudina Podcast me Omer Kaleshin, piktorin sa shqiptar, aq turk dhe francez, hapet cikli në youtube “Shqiptarët e Mrekullueshëm”. Një bashkëpunim i Bankës Amerikane të Investimeve dhe Rudina Xhungës me Dritare.net.
- Programin “Nga e para” transmetuar në Vizion Plus TV, si sponsor i përgjithshëm.
- “Ma jep dorën” në ORA NEWS
- Në 20 shtator, koncertin “Time Capsule” nga CAPITAL T, në Sheshin “Nënë Tereza”.
- Në 23 korrik, koncertin e veçantë në Amfiteatrin e Ti-






ranës realizuar nga Orkestra Verore.

- Në 12 korrik, koncertin “America the Beautiful” nga Kasriot Tusha & Friends.
- Në 21-22 korrik, aktivitetin “Hemingway Jazz Fest No.7”, pranë Universitetit Politeknik Tiranë, në Sheshin Nënë Tereza.

Credins Bank

- Mbështeti Dajti Trail Running, maratonën e vrapimit malor organizuar nga Trail Running Albania.
- Mbështeti Bashkinë Tiranë, në organizimin e koncertit të këngëtarëve Soni Malaj & Majk pranë Amfiteatrit të Liqenit.
- Në 03-05 maj, mbështeti “Albania Climbing Festival” organizuar nga “Rock Tirana Climbing Gym” në Bovillë.
- Në 8 maj - 11 maj, mbështeti veprimtarinë më të madhe në vend të paragliding Albanian Open organizuar në qytetin e Vlorës me pjesëmarrjen e më shumë se 70 pilotëve nga e gjithë bota.
- Mbështeti Koncertin Mbrëmja e Romanës në Sallën e Koncerteve të Fakultetit të Arteve, në nderim të artistit Tonin Arapi.
- Mbështeti Kampionatin e dytë Ndërkombëtar të Taekwondo.
- Mbështeti Koncertin “Të gjitha rrugët të çojnë në Tiranë”.
- Mbështeti Koncertin me violinë të nëntë vjeçares së talentuar Anamaria Prendi në qytetin e Lezhës.
- Mbështeti Maratonën e Këngës 2019 në 12 qytete të Shqipërisë.
- Mbështeti Festivalin “Muzika Internacionale në Korçë”, një festival në qytetin e Korçës.
- Mbështeti Bashkinë Tiranë në Festivalin e Letërsisë në Mantova.
- Mbështeti Klubin shumësportesh Tiranë, për blerjen e materialeve sportive.
- Mbështeti Komandën e Forcës Detare në organizimin e Ceremonisë Zyrtare me rastin e 94 vjetorit të krijimit ku u dhanë medaljet të karrierës për një pjesë të personelit aktiv, si dhe certifikata mirënjohjeje për ish-ushtarakët të cilët kanë shërbyer ndër vite në këtë strukturë.
- Mbështeti Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, duke mundësuar dhënien e çmimeve të aktivitetit të “Colours of Albania”, një aktivitet për promovimin e vlerave të Shqipërisë anembanë botës.
- Mbështeti Festivalin e 11-të, i cili u rikthye pas 47 viteve në Bunk’Art1.
- Mbështeti “I’m from Tirana”, një koncert nga artisti Kuj-



tim Prodani i cili u mbajt pranë Teatrit Eksperimental “Ar-Turbina”.

- Mbështeti Shoqatën Partizani voley për meshkuj, për të cilën Banka ka financuar blerjen e materialeve sportive dhe pjesëmarrjen në kampionatin kombëtar.
- Mbështeti aktivitetin kulturor “Çmimet Kult”. 78 nominime dhe 15 çmime të mëdha në një natë magjike në edicionin e 15-të.
- Në muajin mars, mbështeti Bashkinë Skrapar në organizimin e aktivitetit mbi hapjen e sezonit turistik në Skrapar si dhe organizimin e aktivitetit festiv “Skrapari në gotë”.
- Në festën e 1 qershorit, mbështeti fëmijët e stafit të Bankës Credins mblodhën mjaft libra për t’ua dhuruar bashkëmoshatarëve të tyre në Shtëpitë e Fëmijëve në qytetet e Shkodrës, Durrësit dhe Korçës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania, më 11–20 qershor 2019, përkrahu projektin studentor: “E dua teatrin” ku studentët të 4 fakulteteve të ndryshme nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Marin Barleti (Ekonomik, i Mjekësisë dhe Histori-Filologji) vunë në skenë shfaqje të cilat i përgatitën vetë, me ndihmën e regjisorëve të rinj.

Banka OTP Albania, në mbështetje të artit dhe kulturës në vend, financoi projektin filmik “I Love Tropoja”.

Raiffeisen mbështeti:

- Teatrin e Operës dhe Baletit, si partnere e të gjitha shfaqjeve artistike gjatë vitit 2019.
- Teatrin Kombëtar, për të gjitha shfaqjet e kalendarit artistik gjatë vitit 2019.
- Teatrin e Kukullave në kalendarin e gjithë vitit 2019.
- Festivalit të Muzikës “Different Trains”.
- Në 29-30 prill, edicionin e dytë të festivalit Ballkan Jazz showcase.
- Edicionin e katërt të Swing Marathon, 12 orë muzikë Jazz e viteve ’50-’60 nga Tirana në Shkodër.
- Edicionin e dytë të “Color Day Festival”.
- Edicionin e 6-të të festivalit të Muzikës së Vjetër Baroke Vox Baroque Albania.
- Shfaqjen e baletit “Takohe mi në Moulin Rouge”.
- Edicionin e 14-të të Festivalit të Muzikës së Dhomës, Durrës.
- Festivalin mbarëkombëtar të komedisë “Koko Fest 2019”.
- Koncertin “Tre Tenorët”.
- “Rock Festival” në qytetin e Korçës.





- Festivalin teatror midis shkollave të mesme.
- Komedinë "Nuk shoh, nuk dëgjoj, nuk flas".
- Komedinë "Tango".
- Koncertin "Duo Forte Piano".
- Festivalin e peizazheve muzikore, opera "Incanto"
- Festivalin e Fëmijëve në Shkodër.
- Ciklin e 24 dokumentarëve "Alien", me fokus promovimin e Shqipërisë.

Tirana Bank

- Sponsorizoi Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit Profesional "Kadri Roshi".
- Mbështeti projektin "Lezha Talent 2019", ku fëmijët e grup moshës 07-15 konkurruan në fushat e vallëzimit të aktrimit dhe të kënduarit. Ngjarja përfundimtare për këtë konkurs u zhvillua në 1 qershor 2019 në ambientet e Pallatit të Kulturës së Lezhës.

Union Bank edhe gjatë vitit 2019, ka vijuar mbështetjen e saj për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit, si vijim i marrëveshjes me Federatën Shqiptare të Futbollit të rinovuar për periudhën 2018-2020.

Në mbështetje të sfidave të Kombëtares në fazën finale të eliminatorëve të Evropianit 2020, Union Bank ka organizuar një sërë aktiviteteve sensibilizuese, si: Ditët Kuqezi në degët dhe zyrat e Union Bank, blerje e biletave për stafin dhe klientët për të mbështetur kombëtaren në stadium dhe organizimin e një sërë rubrikash mbështetëse për ndeshjet dhe lojtarët në rrjetet sociale të Union Bank.



